



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 60, datë 30.04.2024

PËR

MIRATIMIN E "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SH.A., E REGJISTRUAR PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT TË SHITJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, EDHE PËR NËNFONDET E NJOHURA: "EURIZON MANAGER SELECTION FUND-MS 10", "EURIZON MANAGER SELECTION FUND-MS 20", "EURIZON MANAGER SELECTION FUND-MS 40", "EURIZON MANAGER SELECTION FUND-MS 70", "EURIZON FUND-BOND AGGREGATE EUR SHORT TERM", NËN ADMINISTRIMIN E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË NJOHUR "EURIZON CAPITAL" S.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, neneve 101 dhe 102, të ligjit nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", si dhe rregullores nr. 38, datë 31.03.2023 "Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së dhe të Fondeve të Investimeve Alternative të themeluara në një vend anëtar të BE-së", e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a., e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shitjes në Republikën e Shqipërisë, edhe për nënfondet e njohura: "Eurizon Manager Selection Fund-MS 10", "Eurizon Manager Selection Fund-MS 20", "Eurizon Manager Selection Fund-MS 40", "Eurizon Manager Selection Fund-MS 70", "Eurizon Fund-Bond Aggregate EUR Short Term", nën administrimin e shoqërisë administruese të njohur "Eurizon Capital" S.A.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit dhe Drejtorja e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**